

VENDIM
Nr. 259, datë 21.12.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 16.11.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘IDI 2005’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘KAMIÇAN’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1860 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/6 prot., datë 17.12.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kamëçan’ me kapacitet të instaluar 1860 kw”,

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, është licencuar shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kw”, në zbatim të miratimit përfundimtar të MIE-s dhënë me shkresën nr. 3157/1, prot., datë 16.4.2020, për ndërtimin e HEC “Kamëçan”, me kapacitet prodhues 1860 kw.

- Kushti i pikës 4, të vendimit 188/2020, kërkon: 4. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., të depozitojë në ERE qëndrimin e OSSH sh.a. në lidhje me kërkesën për korrigjimin e gabimit material në miratimin e pikës së lidhjes nga OSSH sh.a., për kapacitet të instaluar 1860 kw, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Në kuptim të sa më sipër cituar dhe pas një korrespondence të gjatë midis ERE-s, shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. dhe OSSH sh.a. dhe (së fundi shkresa e ERE-s nr. 376/9 prot., datë 28.10.2021), shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1102 prot., datë 24.11.2021, ka bërë me dije se në plotësim të kushtit të vendosur nga ERE në vendimin nr. 188/2020, është ndryshuar/korrigjuar kapaciteti i instaluar i HEC-it “Kamëçan” në miratimin e pikës së lidhjes.

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresën e OSSH sh.a. me nr. 9125/1 prot., datë 22.11.2021, me anë të së cilës kjo e fundit ka ndryshuar/korrigjuar kapacitetin e instaluar të HEC-it “Kamëçan” nga 1680 kw, në 1860 kw sipas: kontratës nr. 621 REP., nr. 116/3 KOL., datë 21.5.2020, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kamëçan’, me kapacitet 1860 kw, në përroin e Kamëçanit dhe përroit të Bistës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit “IDI 2005” sh.p.k.; miratimit përfundimtar të MIE-s dhënë me shkresën nr. 3157/1, prot., datë 16.4.2020, për ndërtimin e HEC “Kamëçan”, me kapacitet prodhues 1860 kw dhe rrjedhimisht vendimit të ERE-s nr. 188/2020, për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kw.

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, pika 4, e vendimit nr. 188/2020 duhet të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë dispozitivin e vendimit nr. 188, datë 16.11.2020, si vijon:

Pika 4, e vendimit nr. 188/2020, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti